

Data: 23/04/2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Toner per makinat fotokopjuese -30125120-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,680,016 (Gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëmbëdhjetë lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Bazuar sa më sipër

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit të përlllogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit: Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar). Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 19% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, AK synon të sigurojë se operatori ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar produkte apo shërbime që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Përvojat e mëparshme në kryerjen e furnizimeve të ngjashme janë një indikator i rëndësishëm i aftësisë së operatorëve për të menaxhuar projekte dhe për të përmbushur afatet dhe standardet e kërkuara. Nëse një operator ka një histori të suksesshme të realizimit të kontratave të ngjashme, kjo ul mundësinë e dështimit të kontratës së re, duke e bërë procesin më të sigurt dhe më të besueshëm për palën kontraktuese.

Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që kërkohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për projekte që kërkojnë cilësi të lartë dhe përputhje me standardet. Përvoja e mëparshme tregon se operatori ka kapacitetin për të siguruar cilësinë dhe të përmbushë kërkesat kontraktuale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) SSH ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) SSH ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”;

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

SSH ISO 9001:2015 kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik aplikon një sistem të menaxhimit të cilësisë, duke siguruar standardizim të proceseve, rritje të efikasitetit dhe ofrim të shërbimeve në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor;

SSH ISO 27001:2013 kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik ka të implementuara masa për menaxhimin e sigurisë së informacionit, duke qenë se mallrat/shërbimet e kërkuara lidhen me pajisje dhe sisteme që përpunojnë dhe transmetojnë të dhëna, përfshirë dokumente dhe informacion të ndjeshëm.

Këto certifikime lidhen drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit dhe janë proporcionale me rëndësinë e garantimit të cilësisë së shërbimit dhe sigurisë së informacionit.

Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë që operatorët ekonomikë disponojnë standarde të provuara ndërkombëtare për menaxhimin e proceseve dhe mbrojtjen e informacionit, duke rritur besueshmërinë në realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij teknik, minimalisht 4 (katër) punonjës të kualifikuar dhe të çertifikuar si më poshtë:

- Minimalisht 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhuesit përkatës ose nga institucione të autorizuar çertifikuese, për mirëmbajtjen dhe shërbimin e pajisjeve fotokopje multifunktionale;
- Minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar në administrimin e rrjeteve kompjuterike;
- Minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar për platformat Microsoft 365 dhe/ose Microsoft Server, ose ekuivalente.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Certifikata;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Shkurt 2026 – Prill 2026.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim garantimin që operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin e kontratës.

Në mënyrë më specifike:

Punonjësit e certifikuar për pajisjet fotokopje multifunktionale janë të domosdoshëm për të garantuar mirëmbajtjen, diagnostikimin dhe riparimin sipas standardeve të prodhuesit, duke shmangur ndërhyrjet jo profesionale dhe duke siguruar funksionim të pandërprerë të pajisjeve;

Punonjësi i certifikuar në administrimin e rrjeteve kompjuterike është i nevojshëm për të siguruar konfigurimin, integrimin dhe funksionimin korrekt të pajisjeve në rrjetet ekzistuese të Autoritetit Kontraktor, si dhe për të garantuar stabilitetin dhe sigurinë e komunikimit të të dhënave;

Punonjësi i certifikuar për platformat Microsoft 365 dhe/ose Microsoft Server (ose ekuivalente) është i domosdoshëm për menaxhimin e shërbimeve të lidhura me infrastrukturën IT, përfshirë konfigurimin e shërbimeve, përdoruesve dhe ndërveprimin me pajisjet multifunktionale në ambientet e punës.

Kërkesat e mësipërme janë në raport të drejtë dhe proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve të kërkuara, si dhe lidhen drejtpërdrejt me specifikimet teknike të objektit të prokurimit.

Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë besueshmëri dhe garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke kërkuar një staf të kualifikuar që i përgjigjet në mënyrë efektive nevojave të kësaj procedure prokurimi.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe me nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve nga prodhuesi/ët ose nga distributorë të autorizuar përbën një element thelbësor për vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë. Ky dokument jo vetëm që vërteton burimin dhe origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, por njëkohësisht garanton se operatori ekonomik është i autorizuar zyrtarisht për furnizimin dhe/ose shërbimin e tyre pranë Autoritetit Kontraktor.

Gjithashtu, ky autorizim siguron që mallrat dhe shërbimet e ofruara janë në përputhje me standardet e prodhuesit, duke garantuar cilësi, besueshmëri dhe përputhshmëri me specifikimet teknike të kërkuara. Në këtë mënyrë, reduktohet rreziku i furnizimit me produkte jo origjinale ose jashtë standardeve, si dhe rritet siguria në realizimin korrekt të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar aftësinë reale të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës, duke siguruar një nivel të lartë profesionalizmi, cilësie dhe përgjegjshmërie në zbatimin e saj. Në këtë kuadër, kriteri konsiderohet i arsyeshëm, proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi/ët e pajisjeve që janë objekt i shërbimit, ose nga përfaqësues të autorizuar të tyre, për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion provues, si kontratë shërbimi, marrëveshje bashkëpunimi, autorizim ose certifikatë nga prodhuesi/ët ose përfaqësues të autorizuar të tyre, të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 dhe 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik ofertues disponon autorizimin dhe mbështetjen e nevojshme teknike nga prodhuesi/ët e pajisjeve ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, çka siguron kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit në përputhje të plotë me standardet teknike dhe specifikimet e prodhuesit.

Autorizimi nga prodhuesi ose nga përfaqësues të tij të autorizuar garanton që operatori ekonomik:

- Ka akses në informacionin teknik të përditësuar, manuallet dhe procedurat zyrtare të mirëmbajtjes;
- Përdor pjesë këmbimi origjinale ose të certifikuara;
- Disponon staf të trajnuar dhe të kualifikuar sipas kërkesave të prodhuesit;
- Siguron cilësi, siguri dhe besueshmëri në realizimin e shërbimeve.

Në mungesë të këtij autorizimi, ekziston rreziku që shërbimet të kryhen në mënyrë jo të standardizuar, duke sjellë pasoja në funksionimin e pajisjeve, rritje të kostove të mirëmbajtjes dhe ulje të jetëgjatësisë së tyre.

Për këtë arsye, kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues (kontratë shërbimi, marrëveshje bashkëpunimi, autorizim ose certifikatë) është e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, duke garantuar një nivel të lartë profesionalizmi dhe sigurie në realizimin e shërbimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Procedura e prokurimit për blerjen e tonerave dhe pjesëve për printera është e rëndësishme për të garantuar funksionimin racional dhe efektiv të punës për punonjësit e Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, e cila ka rëndësi thelbësore.

Për të siguruar vijimësinë e punës, Departamenti TIK dhe Automatizim, sektori i mirëmbajtjes së sistemeve, ka evidentuar nevojën e tonerave për pajisjet e printimit dhe fotokopjimit, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në vonesa të proceseve administrative dhe në shkembimin në kohë të dokumentacioneve zyrtare. Për të shmangur ndërprerjet në rrjedhën e punës dhe për të siguruar funksionimin normal të të gjithë njësive të shoqërisë KESH sh.a., është e domosdoshme që të ndërmerret procedura për blerjen e tonerave dhe pjesëve të tjera të konsumueshme si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemit të menaxhimit të printimit.

Aktualisht në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare janë 21 pajisje printimi për të cilat kërkohet furnizim i vazhdueshëm me toner, drum, waste cartridge, furrë (fuser). Gjithashtu kërkohen shërbime mirëmbajtje parandaluese dhe riparuese për pajisje multifunksionale (MFP) të markës Xerox dhe mbështetje teknike (mirëmbajtje) për sistemin ekzistues të menaxhimit të printimit.

Në zbatim të urdhërit të Administratorit me Nr.68 date 20.02.2026 për hartimin e *Termave të Referencës mbi procedurën e prokurimit me objekt: ‘Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre’*, Grupi i Punës hartoi Termat e Referencës të nevojshme për kryerjen e kësaj procedure duke ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që specifikimet teknike dhe kriteret e nevojshme të jenë në përputhje me standartet e aplikueshme dhe me nevojat e shoqërisë. Bashkëlidhur këtij procesverbal do të gjeni termat e referencës dhe specifikimet teknike.

Njësia e prokurimit